



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 55 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23/05/2022

**VENDIM**

Nr.15, date 23 /05/2022

**PËR**

**PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NË DIGEN E VASJARIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.05.2022 mori në shqyrtim problematikat e konstatuara në digen e Vasjarit që është në administrim të Bashkisë Memaliaj. Në mbledhje ishin të ftuar përfaqësuesit e bashkisë Memaliaj të cilët dhane shpjegimet në lidhje me këtë situatë. Sipas përfaqësuesit të Bashkisë, diga është e dëmtuar dhe jashtë funksionit prej më se 8 vitesh dhe rezervuari i krijuar prej saj është i mbushur me sedimente. Bazuar në informacione të dhëna, Antaret e KKDM arritën në përfundim se për këtë digë e cila aktualisht është jashtë funksionit duhet të kryhet një analizë e plote profesionale për gjendjen aktuale të saj, shkaqet e prishjes së saj si dhe për masat që duhet të ndermerren në të ardhmen. Gjate mbledhjes u vu theksin përveç problematiks se konstatuar nga KKDM edhe mungesa e informacionit nga përdoruesi i digës ndër vite, rrezikshmëria e digës në gjendjen aktuale dhe mungesa e monitorimit dhe analizës së kësaj situatë.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Ti kërkoj shfrytëzuesit të digës së Vasjarit (Bashkia Memaliaj) të hartoj një raport për Sigurinë e digës ku duhet të përfshihen analiza e gjëndjes aktuale dhe e shkaqeve që kanë sjellë këtë problematikë, masat që janë marrë për operimin dhe mirëmbajtjen e digës si dhe plani i gadishmërisë në rastet e emergjencave civile. Në raport duhet të jepen përveç konkluzioneve për sigurinë e digës edhe masat që do të ndermerren në të ardhmen nga shfrytëzuesi i digës. Raporti duhet të përgatitet nga ekspertë të kualifikuar, të pavarur dhe të licencuar në sektorin e digave të mëdha. Njëkohësisht, ekspertet duhet të përgatitin kurbën e volumeve aktuale të ujit në rezervuar bazuar në matjet dhe vlerësimin e depozitimeve të materialeve të ngurta (matjet batimetrike të volumeve të ujit në rezervuar) në përputhje me kërkesat e nenit 30 të VKM së mësipërme. Ky raport duhet të dorëzohet pranë SKDM brenda muajit Shtator 2022. Mosdorëzimi i këtij dokumentacioni sipas këtij vendimi do të nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit të mësipërm

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

